



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:019253

Datë: 31.05.2018

Numri i dokumentit: 00049860

P.nr.564/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtarja **DIANA SINA**, me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në lëndën penale kundër të akuzuarit Y. S. nga Gjakova, për shkak të veprës penale, të vjedhjes së shërbimeve komunale, nga neni 320 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, me numër PP.nr.365/2017, të datës 30.08.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën **30.05.2018**, në prezencën e Prokurorit të shtetit Bajram Kryeziu, të akuzuarit, në të njëjtën datë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **Y. S.**, i biri i B., i nënës N. e gjinisë R., data e lindjes....., në Gjakovë, ku edhe tani banon në rrugën "...", ka të kryer shkollën fillore, punëtor fizik, i martuar- atë i 3 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë s h t ë f a j t o r:

Sepse: Me datë të pavërtetuar e deri me dt.21.09.2016 në shtëpinë e tij në Gjakovë, me qëllim që vetit ti sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, me qëllim fitimi, në mënyrë të paautorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike në atë mënyrë që jashtë njehsorit elektrik me nr.... përmes kabllos 5x2.5 ka bërë lidhjen direkt në rrjetin elektrik duke penguar kështu regjistrimin e energjisë së shpenzuar elektrike, gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar Distrikti në Gjakovë me rastin e kontrollës, me ç' rast të dëmtuarës K.D.D.GJ i ka shkaktuar dëm në shumë prej 144.95 euro.

- me çka ka kryer veprën penale të vjedhjes së shërbimeve komunale, nga neni 320 të KPRK-ës.

Gjykata në bazë të nenit 4, 17 par.1, 41, 46, 49, 50, 51, 52 par.5, 73, dhe neni 320 të KPRK-së, si dhe neni 365 të KPPK-së, i shqipton;

DËNIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3(tre) muajve**, dhe dënim me gjobë në shumë prej **100.-(Njëqind) Euro**, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (Një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej **20 Euro**, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

E dëmtuara K. - Distrikti në Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën PP.nr.365/2017, të datës 30.08.2017, kundër të akuzuarit Y.S. nga Gjakova, për shkak të veprës penale, të vjedhjes së shërbimeve komunale, nga neni 320 të KPRK-së. Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit, andaj i ka propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari Y.S. në shqyrtimin fillestar lidhur me fajësinë deklaron se e pranon fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, për të cilën vepër jam penduar pa masë, dhe premtoi se të njëjtën nuk do ta përsërisë, dëmin e shkaktuar të dëmtuarës jam duke e paguar pjesë pjesë së bashku me shpenzimin e energjisë elektrike, shton se jam në gjendje të dobët ekonomike, jam mbajtës i vetëm i familjes, për herë të parë paraqitem në Gjykatë për një vepër të kryer penale, andaj i propozoi gjykatës që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të ketë parasysh rrethanat e lartë cekura.

Duke u deklaruar lidhur me mendimin lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, prokurori i shtetit ka deklaruar se nuk e kundërshton pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë me vullnet dhe vetëdije të plotë dhe i njëjti ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë u bë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi mbështet në faktet dhe provat që përmban aktakuza.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetuar se i akuzuari Y.S.: Me datë të pavërtetuar e deri me dt.21.09.2016 në shtëpinë e tij në Gjakovë, me qëllim që vetit ti sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, me qëllim fitimi, në mënyrë të paautorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike në atë mënyrë që jashtë njehsorit elektrik me nr..... përmes kabllor 5x2.5 ka bërë lidhjen direkt në rrjetin elektrik duke penguar kështu regjistrimin e energjisë së shpenzuar elektrike, gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar Distrikti në Gjakovë me rastin e kontrollës, me ç' rast të dëmtuarës K.D.D.GJ i ka shkaktuar dëm në shumë prej 144.95 euro.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimin të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykuese konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: është baba i tre fëmijëve, gjendjen së dobët ekonomike, është mbajtës i vetëm i familjes, pranimin e fajësisë, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë veprë penale, e sidomos faktin se për herë të parë ndeshet me ligjin, Gjykata ka ardhur në përfundim se me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3(tre) muajve**, dhe dënim me gjobë në shumë prej **100.-(njëqind) Euro**, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (Një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 lidhure me nenin 453 par.1. të KPP-së.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.564/17 me datën 30.05.2018

Procesmbajtësja,
Lamije Kuqi

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Diana Sina

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:019253
Datë: 31.05.2018
Numri i dokumentit: 00049860